

10 VJET



FEMART

# REVOLUCION \ EVOLUCION

10 VJET

RAPORTI NARRATIVI



Ky publikim u botua si pjesë e Femart 10. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Artpolis - Qendra për Art dhe Komunitet dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e donatorëve tanë.



**REVOLUCION** / **EVOLUCION**  
10 VJET

# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJA</b>	<b>6</b>
<b>EDICIONI I 10-TË I FESTIVALIT FEMART - 14-23 QERSHOR, 2022</b>	<b>8</b>
<b>DITA 1 - 14.06.2022</b>	<b>9</b>
HAPJA E FESTIVALIT - PREMIERA E SHFAQJES “TOKA E SHPIRTRAVE TË TRAZUAR” / KOSOVË	9
KOKTEJ DHE NDEJË ME DJ LILAC	11
ECJET DHE EKSPLORIMI “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI	12
<b>DITA 2 - 15.06.2022</b>	<b>13</b>
PERFORMANCË “KËMBËGJATET” / SHQIPËRI	13
AKROBACION & LOJË ME FLAKË “KËMBËGJATET”/SHQIPËRI	14
ECJET DHE EKSPLORIMI “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI	15
KONCERT NGA CHRISTINE SALEM / ISHUJT REUNION	16
<b>DITA 3 - 16.06.2022</b>	<b>17</b>
PUNËTORIA MOZAIKU KLIMATIK / FRANCË	17
ECJET DHE EKSPLORIMI “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI	18
SHFAQJE TEATRORE “BABAI DHE BABAI” / KOSOVË	19
<b>DITA 4 - 17.06.2022</b>	<b>20</b>
TRAJNIMI “EDUKIMI I GRAVE TË REJA MBI FEMINIZMIN” / KOSOVË	20
ECJET DHE EKSPLORIMI “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI	21
PERFORMANCË “VALS I KËPUTUN” / GJERMANI, SHQIPËRI	22
PERFORMANCA “NË PRAG TË THYERJES” / SERBI	23
PERFORMANCA “NATA E DIVAVE” /SERBI	24
<b>DITA 5 - 18.06.2022</b>	<b>25</b>
ECJET “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI	25
SHFAQJA TEATRORE “BURRAT” / PORTUGALI	26
<b>DITA 6 - 19.06.2022</b>	<b>27</b>
LIGJERATË & PERFORMANCË “25 GOTA VERË” / DAH TEATËR / SERBI	27
ECJET “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI	28
SHFAQJA TEATRORE “BURRNESHAT” / KOSOVË	29
<b>DITA 7 - 20.06.2022</b>	<b>30</b>
KONFERENCË & PUBLIKIM RAPORTI “MARRËDHËNIET GJINORE DHE PUSHTETI” - #METOO NË ARTE: NGA THIRRJET TEK NDRYSHIMI STRUKTUROR / NGA IETM (RRJETI NDËRKOMBËTAR PËR ARTET PERFORMUESE BASHKËKOHORE), ON THE MOVE – OTM, DHE FACE-FRESH ARTS COALITION EUROPE / PJSË E PROJEKTIT ERASMUS+ SHIFT	30

MASTER KLASË NGA MIRIAM ENGEL - ANGELA DANCE CO. / IZRAEL	33
ECJET “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI	34
SHFAQJE TEATRORE & DISKUTIM “ENIGMA E REVOLUCIONIT” / TEATRI DAH / SERBI	35
<b>DITA 8 - 21.06.2022</b>	<b>36</b>
MASTER KLASË NGA MIRIAM ENGEL - ANGELA DANCE CO. / IZRAEL	36
PREZANTIM PËR MEDIA “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI	37
SHFAQJA TEATRORE “PA ZË” / SHQIPËRI	38
ECJET E DREJTUARA ME PUBLIKUN “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI	39
<b>DITA 9 - 22.06.2022</b>	<b>40</b>
DEMONSTRIM/VETËMBROJTJE “ÇIKAT E SJELLSHME” / KOSOVË	40
PERFORMANCË ARTISTIKE “NDAL LUFTËN” NGA MIRIAM ENGEL / IZRAEL	41
ECJET E DREJTUARA ME PUBLIKUN “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI	42
<b>DITA 10 - 23.06.2022</b>	<b>43</b>
PREMIERA E SHFAQJES TEATRORE “ORA E VDEKJES” / KOSOVË, SHQIPËRI	43
ECJET E DREJTUARA ME PUBLIKUN “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI	44
MBYLLJA E FESTIVALIT – PREZENTIM SPECIAL: FLAMENKO BALETI “LUXURIA”/ SPANJË	45
ARTPOLIS DHE FEMART NDEROJNË ARTISTEN VJOSA BERISHA	46
BLLOGJET E FEMART 10	47
REZULTATET KRYESORE	48
KOMUNIKIMI DHE PROMOVIMI	49
MONITORIMI DHE VLERËSIMI I REZULTATEVE	52
STAFI I ARTPOLIS DHE FESTIVALIT FEMART	53
TRUPA ARTISTIKE REZIDENTE E ARTPOLIS	54
FEMART 10 U MBËSHTET NGA	55

# PËRMBLEDHJA

Ky vit shënoi edicionin e 10-të jubilar të Festivalit Ndërkombëtar të Artisteve dhe Aktivisteve – FemArt. Motoja e 10-vjetorit të Festivalit FemArt ishte “Nga Revolucioni në Evolucion”.

## REVOLUCION \ EVOLUCION 10 VJET

Evolucioni feminist vazhdoi. Sivjet edhe më i gjerë e më i plotë. Artiste, aktiviste e feministe vendore dhe ndërkombëtare u pikëtakuan sërish në Festivalin e parë feminist në Kosovë e më të madhin në rajon, FemArt.

FemArt 10, për dhjetë ditë me radhë, 14-23 qershor 2022, shpërfaqti aftësinë e grave artiste për t’u përmbushur, inspiruar e për të gjetur paqen. U mbledhëm për të festuar një dekadë të njohjes e nderimit të guximit të grave artiste, fuqisë kreative, e angazhimit të tyre për barazi e drejtësi përmes shfaqjeve teatrore, baletit flamenko, vallëzimit bashkëkohor, koncerteve, konferencave, diskutimeve, trajnimeve dhe punëtorive nga Kosova, Shqipëria, Serbia, Gjermania, Portugalia, Spanja, Izraeli, Ishujt Reunion, Italia dhe Franca.

Një dekadë guxim, krenari e dashuri. Për një dekadë kemi krijuar ngjarje, thyer barriera e ndërtuar ura të reja të paqes në vend, rajon e më gjerë. Jemi rebeluar për të këputur fijen e patriarkatit, e shkundur mendësinë e dëmshme të së vjetrës.

Aktivizmi ynë artistik-feminist erdhi si një përgjigje për t’u shëruar e kuptuar, për të krijuar e transformuar shoqërinë e jetën. Mbi të gjitha për të shkërmuar secilin nocion të normuar mbi pabarazinë. Ky angazhim ka frymuar falë dashurisë për artin, aktivizmin, jetën, ekzistencën, barazinë e drejtësinë.

Në këtë dhjetë vjetor, për dhjetë ditë festuam e u rebeluam, argëtuam e inspiruam, performuam e bëmë thirrje për barazi, drejtësi, fuqizim e njohje të kontributit të grave, artisteve e aktivisteve deri në revolucionin e radhës.

Festivali FemArt filloi si një ambicie dhe dëshirë e themelueses dhe drejtoreshës ekzekutive të Artpolis dhe Festivalit FemArt, Zana Hoxhës. FemArt ishte një domosdoshmëri për shoqërinë brenda vendit tonë dhe në rajon. Ai vazhdoi të zgjerohej vetëm për t'i dhënë hapësirë artit, solidaritetit, humanizmit, paqes, lirisë, argëtimit, gëzimit, ndjeshmërisë dhe fuqizimit.

Duke pasur parasysh vështirësitë me të cilat ballafaqohen në baza ditore gratë dhe grupet e marginalizuara në Kosovë dhe në rajon, duke u ngritur nga këto pengesa, duke u përballur dhe thyer normat sociale ndër breza, Qendra për Art dhe Komunitet – Artpolis për dhjetë vjet, që nga viti 2013, ka organizuar Festivalin FemArt me qëllim për të luftuar sfidat patriarkale të imponuara mbi gratë dhe vajzat ndër vite.

Kjo nismë e bukur artistike u bë një platformë për t'u dëgjuar artistë/e dhe aktivistë/e, dhe që në edicionin e saj të parë mori formën e një festivali prestigjioz.

Festivali vazhdon të jetë një hapësirë për inicimin dhe prezantimin e ideve dhe krijimeve që sjellin përpara konceptet feministe dhe zhvillimin e saj në Kosovë, si dhe avokimin për të drejta të barabarta dhe ndërtimin e paqes në rajon.

FemArt mblodhi së bashku gra artiste vendase, rajonale dhe ndërkombëtare të të gjitha llojeve të ekspertizës, nga debutuese deri te profesionistët me përvojë. Aty përfshiheshin gra artiste dhe aktiviste, si dhe burra me qëndrime feministe, krijues filmash, interpretues teatrore, fotografë/e, muzikantë/e, shkrimtarë/e, së bashku me krijuese dhe profesionistë/e **të tjerë që kontribuan me kërkime, diskutime dhe shkëmbim informacioni.**

Programi i larmishëm i Festivalit FemArt është jo vetëm edukativ, por edhe argëtues, i cili ka arritur të fitojë një audiencë të gjerë, të cilit i ka dhënë njohuri e përvojë të gjerë përmes veprave artistike. Këto programe të edicioneve të kaluara u përzgjedhën nga një grup artistësh dhe aktivistësh të shoqërisë civile, **të cilët kanë përvojë në forma të ndryshme arti që kanë një lidhje mes çështjeve sociale dhe krijimeve artistike.**

Të frymëzuar nga temat sociale dhe të drejtat e njeriut në Ballkan, artiste/ë dhe aktiviste/ë u bashkuan në këtë platformë dinamike të festivalit dhe në mënyrë artistike informuan publikun për problemet sociale me të cilat përballen gratë e Kosovës dhe të rajonit çdo ditë.

Statistikat e FemArt ndër vite na japin kurajë për të vazhduar punën tonë, si p.sh.: rreth 2150 artistë/e dhe aktivistë/e **të pranishëm për 10 vjet; rreth 29,000 njerëz kanë ndjekur fizikisht aktivitetet e FemArt gjatë kësaj dekade, dhe këtë vit vetëm FemArt arriti në më shumë se 348,432 njerëz në internet.**

Së bashku jemi më të fuqishëm dhe nuk do të ndalemi, derisa të arrijmë synimet tona drejt lirisë, drejtësisë, barazisë dhe arsimimit për të gjitha gratë dhe vajzat në Kosovë.

# EDICIONI I 10-TË I FESTIVALIT FEMART

14-23 QERSHOR, 2022

**Edicioni i 10-të i Festivalit FemArt, nën moton “Nga Revolucioni në Evolucion”, u mbajt në datat 14-23 qershor 2022 me një program të përbërë nga 34 (tridhjetë e katër) aktivitete, ku artiste/ë dhe aktiviste/ë nga komunitetet lokale dhe ndërkombëtare u mblodhën për të festuar dhe rebeluar, për t’u argëtuar dhe frymëzuar, performuar dhe për të bërë thirrje për barazi, drejtësi, fuqizim dhe njohje të kontributit të grave, artisteve dhe aktivisteve, deri në revolucionin e ardhshëm.**

Duke kujtuar se barazia gjinore është thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ashtu që funksionimi i demokracisë dhe shtetit ligjor përveç artit duhet të promovojë mirëqenien për të gjithë, të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, si dhe të njëjtin vizibilitet, fuqizimin, përgjegjësinë dhe pjesëmarrjen në të gjitha sferat e jetës publike dhe private, dhe se kjo nënkupton qasje dhe shpërndarje të barabartë të burimeve midis grave dhe burrave.

Ne kemi një rrugë të gjatë përpara nesh në krijimin e një shoqërie të barabartë, gjatë kësaj periudhe kemi punuar në një program të larmishëm për Festivalin FemArt 10 për të ngritur zërin tonë për një shoqëri të barabartë, të drejtat e grave dhe fuqizimin e grave dhe grupeve të nën-përfaqësuar.

Festivali FemArt 10 përfshiu aktivitete e mëposhtme:

## DITA 1 14.06.2022

### HAPJA E FESTIVALIT - PREMIERA E SHFAQJES “TOKA E SHPIRTRAVE TË TRAZUAR” / KOSOVË



Shfaqja “Toka e Shpirtrave të Trazuar” hapi edicionin e dhjetë të Festivalit FemArt në Teatrin Kombëtar të Kosovës para 350 personave në audiencë.

“Toka e Shpirtrave të Trazuar” është një performancë e bazuar në poezitë e Shqipe Malushit, të cilat evokojnë kujtimet tona kolektive për mungesën e paqes dhe përballjen me luftën dhe konfliktin si një gjendje konstante për shoqërinë kosovare ndër shekuj e në veçanti ndikimin e saj në traumat tona ndër gjenerata.

E shtrirë në një format unik eksperimental, performanca e regjisores Zana Hoxha krijoi një sinergji multidisiplinare përmes poezive imazhiste të Malushit, koreografisë bashkëkohore teatrore të Robert Nuhës, dhe dramaturgjisë së Shpëtim Selmanit, muzikës eksperimentale me elemente burimore dhe këndimit, si dhe video projeksioneve që krijojnë një narrativë të re të bazuar mbi kujtesën tonë kolektive.

Fragmente dhe tekste të ndryshme poetike të mbushura me dhimbje, luftë, shpresë, forcë, si imazh i qëndresës sonë kolektive, u interpretuan nga Trupa Artpolis Resident Artpolis, së



bashku me artistë/e të muzikës dhe kërcimit në këtë projekt. Përmes akteve kronologjike “Toka e Shpirtrave të Trazuar” përshkroi një nga etapat më të rëndësishme të kosovarëve/eve drejt asaj që kishin ëndërruar me shekuj: lirinë.

Por a mjafton të jesh i lirë? Apo ka ndonjë gjë përtej saj?

“Toka e Shpirtrave të Trazuar” është një album fotografik që nuk duhet të mbulohet kurrë nga pluhuri, apo të harrohet në një sirtar.



## KOKTEJ DHE NDEJË ME DJ LILAC



Pas premierës së shfaqjes “Toka e Shpirtrave të Trazuar” publiku pati rastin të argëtohej nën tingujt e DJ Lilac në korridorin e Teatrit Kombëtar të Kosovës, shoqëruar nga një koktej rasti.


## ECJET DHE EKSPLORIMI “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI



“Qytetet Natën” ishte një projekt me pjesëmarrëse gra, i cili vë në pah perceptimin e tyre për rrezikun në mjedisin urban. I konceptuar nga artistja italiane Valentina Medda, ky aktivitet u jetësua përgjatë dhjetë ditëve në Prishtinë, dhe ishte i hapur për publikun në tri ditët e fundit të Festivalit FemArt. Në qershor, 12 gra vendore me etni, moshë dhe prejardhje të ndryshme, u ftuan nga artistja për të eksploruar rrugët e Prishtinës, duke u endur të vetme pas perëndimit të diellit, duke shmangur kalimin e zonave ku nuk ndiheshin rehat. Duke bërë këtë,

secila ripërcaktoi topografinë e qytetit, duke ripërcaktuar kufijtë e tij përmes trupit të tyre të vendosur dhe përvojës së tyre fizike të vendit, por gjithashtu (të pavetëdijshme) nga prejardhja e tyre kulturore, statusi i tyre ekonomik, besimet e tyre dhe paragjykimet e tyre të brendshme.

Rezultati i këtyre eksplorimeve ishte një seri shëtitjesh “Prishtina Natën”, me ç’rast publiku u ftua të ndjekë hapat e pjesëmarrëseve dhe të përjetojë frikën e tyre, duke ecur përgjatë disa kufijve që nuk ishin thjesht gjeografikë, por fizikë, emocionalë dhe politikë.



## DITA 2 15.06.2022

### PERFORMANCË “KËMBËGJATET” / SHQIPËRI



“Këmbëgjatet” argëtuuan publikun me ecjen akrobatike në sheshet e Prishtinës. Rreth 50 fëmijë, të rinj/reja, e të moshuar patën rastin të krijonin kujtime me më të dashurit e tyre duke shkrepur foto e video me këmbëgjatet. Pjesa më sfiduese gjatë qëndrimit mbi këmbalecët është: qesh gjithmonë dhe ruaj ekuilibrin.



## ACROBACION & LOJË ME FLAKË “KËMBËGJATET”/SHQIPËRI



Përderisa ecja akrobatike u zhvillua jashtë, duke ecur nga sheshi “Zahir Pajaziti”, përmes sheshit “Nënë Tereza” deri te sheshi “Skënderbeu”, performancat me akrobacione dhe zjarr u zhvilluan në Teatrin Kombëtar të Kosovës duke argëtuar publikun me veprime spektakolare. Rreth 120 persona ishin prezent në këtë spektakël të këmbëgjatave.



## ECJET DHE EKSPLORIMI “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI



Gratë udhëheqëse eksploran qytetin dhe bënë ecje në zonat e zgjedhura nga ato. Ecjet dhe shëtitjet e tyre u zgjodhën në ndjenjat dhe frikën e tyre. 12 gratë pjesëmarrëse i ndanin informacionet rreth pikës së nisjes dhe ndalimin me artisten Valentina Medda.



## KONCERT NGA CHRISTINE SALEM / ISHUJT REUNION



Festivali i Muzikës (Fête de la Musique), i cili zhvillohet nën patronatin e Ambasadës Franceze, solli në Prishtinë këngëtarën Christine Salem. Para publikut në Prishtinë, Salem prezantoi këngë edhe nga albumi i saj i fundit “Mersi”. Për këtë album të ri, këngëtarja dhe kantautorja ikonë nga Ishujt Reunion përzien instrumentet perkusioniste me meloditë e një violine virtuoze. Në këngët e saj, të ngjyrosura me blues, maloya apo rock, ajo falënderon paraardhësit e saj dhe i këndon shpresës për një botë më të mirë. E pakompromis,

por me ndjeshmëri të vërtetë, në forcën dhe butësinë e saj, “Mersi” i ngjau Christine Salemit. Në ditën e dytë festivalit Salem u dha një mbrëmje të paharrueshme 170 të pranishmëve në Teatrin Oda.



## DITA 3 16.06.2022


### PUNËTORIA MOZAIKU KLIMATIK / FRANCË



“Mozaiku Klimatik” ishte punëtori që synonte të rriste ndërgjegjësimin dhe mirëkuptimin e njerëzve rreth ndryshimeve klimatike. Shpjegoi funksionimin e klimës dhe pasojat e prishjes së saj. Përmes kësaj punëtorie 20 pjesëmarrëse patën rastin të kuptojnë çështjet klimatike përmes të dhënave shkencore, për ndërtimin e kapaciteteve të ekipeve si inteligjencë kolektive. Për të informuar pjesëmarrëset u përkujdesën trajnerët Ben Dida dhe Marie Grovel.



## ECJET DHE EKSPLORIMI “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI



Gratë udhëheqëse eksploran qytetin dhe bënë ecje në zonat e zgjedhura nga ato. Ecjet dhe shëtitjet e tyre u zgjodhën në ndjenjat dhe frikën e tyre. 12 gratë pjesëmarrëse i ndanin informacionet rreth pikës së nisjes dhe ndalimin me artisten Valentina Medda.



## SHFAQJE TEATRORE “BABAI DHE BABAI”/ KOSOVË



OJQ Integra ka realizuar një tjetër projekt teatror i cili në një mënyrë të jashtëzakonshme e trajton çështjen e personave të pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë. Me një ndërthurje mahnitëse mes trajtimit të kësaj çështjeje nga aspekti i “të pagjeturve” dhe nga aspekti i atyre që ata lanë pas, kjo shfaqje na solli jetën dhe sfidat e një familje normale e të zakonshme, të paktën në dukje. Shfaqja paraqiti jetën e Dinit, i cili jeton me gruan e vet Sarën dhe vajzën e tyre Lolën. Jeta e tyre është goxha e njëtrajtshme, megjithatë, kjo njëtrajtshmëri duket se vjen nga hallet e

problemet e jetës me të cilat ballafaqohen. Por, përtej kësaj ‘njëtrajtshmërie’, duket se në shtëpi ka edhe një palumturi të pashpjegueshme. “Babai dhe Babai”, në dukje një dramë për sfidat e zakonshme të jetës së një familjeje, na zbuloi një histori tronditëse dhe një traumë të thellë shoqërore, një plagë që ka ngelur e pashëruar dhe e cila personazhet i mban peng, përgjithmonë. “Babai dhe Babai” u prezantua në Muzeun Etnologjik para 50 personave në audiencë.



## DITA 4 17.06.2022

### TRAJNIMI “EDUKIMI I GRAVE TË REJA MBI FEMINIZMIN” / KOSOVË



Trajnimi “Edukimi i grave të reja mbi feminizmin”, u fokusua në fuqizimin e vajzave duke iu zgjeruar njohuritë mbi feminizmin. Këtë herë ky trajnim u realizua në qytetin e Graçanicës me 10 vajza të komunitetit serb, të cilat patën mundësi të mësojnë nga aktivistet Nevenka Rikalo dhe Gordana Toskić. Këto vajza mësuuan mbi definicionet, historinë e lëvizjeve feministe në botë, si dhe zhvillimin e feminizmit në Kosovë e mundësinë që ato të kontribuojnë në aktivitete të ndryshme. Ky trajnim shërbeu si platformë për ndarjen e përvojave dhe sfidat me

të cilat përballen vajzat e këtij komuniteti në Kosovë, duke treguar njëherësh format që ato mund të ndjekin për të tejkaluar sfidat e si të ballafaqohen me stereotipet shoqërore dhe sistemin patriarkal.



## ECJET DHE EKSPLORIMI “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI



Gratë udhëheqëse eksploran qytetin dhe bënë ecje në zonat e zgjedhura nga ato. Ecjet dhe shëtitjet e tyre u zgjodhën në ndjenjat dhe frikën e tyre. 12 gratë pjesëmarrëse i ndanin informacionet rreth pikës së nisjes dhe ndalimin me artisten Valentina Medda.



## PERFORMANCË “VALS I KËPUTUN” / GJERMANI, SHQIPËRI



Publiku i Festivalit FemArt pati rastin të shohë një performancë të veçantë të vallëzimit bashkëkohor - “Vals i këputun”, që është frymëzuar nga një këngë e vjetër arbëreshe, e cila ka mbetur në kujtesën tonë kolektive prej shekujsh, si një motiv i mjegullt. Kjo reminishencë e turbullt zgjoi interesin për të hulumtuar dhe krijuar në lidhje me kujtime të paplota, imazhe ‘të balsamosura’ nga burime të panjohura. Me vals-in ‘e këputun’ si fill lidhës për këto evokime të papritura, thelbi i tyre mbetet i fshehtë, por i gjallë. ‘was bleibt kollektiv’

është një nismë e koreografit të mirënjohur botërisht Gentian Doda. Një bashkëpunim mes artistësh shqiptarë dhe ndërkombëtarë multidisiplinarë që kanë të përbashkët nevojën për të hulumtuar dhe zhvilluar ide përmes aftësive shprehëse të trupit. Fokusi i tyre qëndroi në zbulimin e gjendjes njerëzore nëpërmjet lëvizjes (ose mungesës së saj). E përbashkëta në investigimet e tyre ishte përpjekja për të gjetur elemente të qëndrueshme që mbeten pas çdo manifestimi artistik. 60 persona ishin prezent për ta shijuar këtë performancë nga ‘was bleibt kollektiv’.



## PERFORMANCA “NË PRAG TË THYERJES” / SERBI



Divat e njohura të jetës së natës së Beogradit, Dekadenca dhe Markiza de Sada u prezantuan para publikut në Teatrin Dodona, në Prishtinë, me performancën “Në prag të thyerjes” që synoi të udhëheqë çdo shikues në rrugën e duhur shpirtërore. Kjo shfaqje speciale polemike e njomur në patosin e krishterë me përfshirje të drejtpërdrejta të përdoruesve të praktikave të ndryshme shpirtërore hapi horizonte të reja për audiencën, me fokus promovimin e dashurisë, bashkimit dhe besimit. Audiencia, në përbërje të 150 personave, e zbuloi se

çfarë është Dragape, pse janë të rëndësishme indulgjencat, cilat janë kuptimet e termave pompoz si katekizmi dhe katapetasma, kush është Pacha mama: a është ajauaska që ofron çlirim apo është e vërteta diku atje.



## PERFORMANCA “NATA E DIVAVE” /SERBI



Lady K + Dekadencia janë dyshe kabare që bashkëpunojnë tash e disa vite. Lady K dhe Dekadencia argëtuuan audiencën në Prishtinë me interpretimet e tyre live të hiteve të pop/rock/jazz/showtunes. Këto dy diva e dërguan publikun në një udhëtim të butë, por të egër gjatë natës me përkushtimin e tyre ndaj pasionit, dashurisë dhe shkëlqimit! Ato performuan para 150 personave të pranishëm në Teatrin Dodona.



## DITA 5 18.06.2022

### ECJET “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI



Dymbëdhjetë (12) gratë pjesëmarrëse në “Qytetet Natën” takoheshin me artisten Valentina Medda, e cila i udhëzonte në rrugën që kishin zgjedhur. Secila grua, kishte një orar të ndryshëm dhe një pikënisje. Këto prova ndryshonin nga njëra-tjetra, pasi rruga dhe personi që drejtonte ecjen ndryshonin. Për më tepër, duke qenë se çdo person ka përvojë personale dhe paragjytime, ndjenjat që ato përjetuan të gjithë gjatë provave të tyre ndryshonin.



## SHFAQJA TEATRORE “BURRAT” / PORTUGALI



Shfaqja teatrale “Burrat” me regji të Pedro Alves ishte një komedi për jetën, vdekjen dhe lirinë. Kjo shfaqje që sfidoi “kufijtë ndërmjet teatrit dhe kinemasë” është e bazuar në filmin e vitit 1970, me të njëjtin titull, me skenar dhe regji të John Cassavetes. “Burrat” është e bazuar në një terren të rrjedhshëm aty ku kufijtë tentojnë të ndajnë jetën nga arti, realitetin nga trillimi, dhe teatrin nga kinemaja. Shfaqja u prezantua para 80 personave në Teatrin Kombëtar të Kosovës nga aktoret Leonor Cabral, Joana Cotrim and Carolina Figueiredo.



## DITA 6 19.06.2022

### LIGJERATË & PERFORMANCË “25 GOTA VERË” / DAH TEATËR / SERBI



Kjo ligjeratë/performancë është krijuar për 25-vjetorin e Teatrit DAH. Bazohet në tekstet autobiografike të drejtoreshës së Teatrit DAH, Dijana Milosevic, e cila flet për punën e kompanisë së saj teatrore që ka nisur në një kontekst specifik historik dhe politik të vendit “që nuk është më”. Nëpërmjet të qenit/bërjes pjesë e shoqërisë teatrore u pasqyrua historia e një vendi, por edhe momenti që jetojmë në botën bashkëkohore. Kjo performancë u prezantua në Shtëpinë e Kulturës në Gushtericë, Graçanicë me ç’rast prezent ishin rreth 80 persona.



## ECJET “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI



Dymbëdhjetë (12) gratë pjesëmarrëse në “Qytetet Natën” takoheshin me artisten Valentina Medda, e cila i udhëzonte në rrugën që kishin zgjedhur. Këto prova ndryshonin nga njëra-tjetra, pasi rruga dhe personi që drejtonte ecjen ndryshonin. Për më tepër, duke qenë se çdo person ka përvojë personale dhe paragjykime, ndjenjat që ato përjetuan të gjithë gjatë provave të tyre ndryshonin.



## SHFAQJA TEATRORE “BURRNESHAT” / KOSOVË



Në kuadër të edicionit të 10-të të Festivalit FemArt u prezantua edhe shfaqja e Jeton Nezirajt “Burrneshat”, me regji të Erson Zymberit.

Në shfaqjen “Burrneshat”, antropologja angleze Edith, pas vizitës në veriun e Shqipërisë, takohet me Sose-n, njëren nga pak burrneshat e mbetura shqiptare. Të dyja, pastaj udhëtojnë në Londër, në një seri të prezentimeve publike në London University. Gjatë kësaj vizite, Sose bëhet pjesë e një queer performance që është duke u për-

gatitur nga Julian, që është një drag-queen e njohur e Londrës. Për Sosen takimi me një kulturë kaq të huaj bëhet çështje ekzistenciale.

“Burrneshat” trajton fenomenin e burrneshave, nën dritën edhe të debatit të tanishëm mbi çështjet gjinore, si dhe adreson konceptin e lirisë, respektivisht mos-lirisë në shoqëritë me vlera, koncepte e konstrukte të ndryshme shoqërore. Ky është produksioni i parë në gjuhën shqipe i kësaj drame. Më herët ajo është vënë në skenë në gjermanisht, në Zvicër, si një bashkëprodhim i forever productions, Schlachthaus Theater Bern, Theater Winkelwiese Zürich, Kleintheater Luzern dhe Kellertheater Winterthur. Për ta shikuar këtë shfaqje në Teatrin Oda ishin prezent 120 persona.



## DITA 7 20.06.2022

### KONFERENCË & PUBLIKIM RAPORTI “MARRËDHËNIET GJINORE DHE PUSHTETI” - #METOO NË ARTE: NGA THIRRJET TEK NDRYSHIMI STRUKTUROR / NGA IETM (RRJETI NDËRKOMBËTAR PËR ARTET PERFORMUESE BASHKËKOHORE), ON THE MOVE – OTM, DHE FACE-FRESH ARTS COALITION EUROPE / PJESË E PROJEKTIT ERASMUS+ SHIFT

Dita e 7-të e FemArt 10 nisi në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës me konferencën dhe publikimin e raportit “Gjinia dhe Marrëdhëniet e Pushtetit” - #Metoo Në Arte: Nga Thirrjet Tek Ndryshimi Struktural, me autore Marta Keil (IETM), Katie Kheriji-Watts (OTM), i cili synon të trajtojë situatën në lidhje me seksizmin, ngacmimin, ngacmimin seksual, dhe abuzimin me pushtetin në botën e artit evropian.

Ky publikim nga IETM (Rrjeti Ndërkombëtar për Artet Performuese Bashkëkohore), On the Move – OTM, dhe FACE – Fresh Arts Coalition Europe është kulmi i punës së projektit SHIFT mbi Marrëdhëniet Gjinore dhe Pushtetit. Kjo temë përfshin çështje komplekse, si në shoqëri në përgjithësi ashtu edhe në sektorin kulturor. Në dritën e zhvillimeve që nga viti 2017, kur lëvizja #MeToo u ngrit në rëndësi globale, partnerët e SHIFT morën një vendim të përbashkët për t’u fokusuar në ngacmimin seksual dhe abuzimin me pushtetin në botën e artit evropian.

Ky aktivitet u hap nga presidentja e Kosovës, shkëlqesia e saj, dr. Vjosa Osmani – Sadriu, e cila dha një mesazh inspirues për të pranishmit dhe ndjekësit e rrjeteve sociale të FemArt, duke theksuar se secili hap drejt barazisë gjinore ka rëndësinë e vet, dhe të gjithë duhet të angazhohemi për një gjë të tillë.





“Ju falënderoj që nëpërmjet artit keni përzgjedhur që të përçoni mesazhe të rëndësishme për shoqërinë tonë dhe që nëpërmjet kësaj përpjekjeve e keni në qendër të vëmendjes pikërisht fuqizimin e grave dhe vajzave. Për mua dhe për gjithë zyrën time është nder që t’iu mbështesim sadopak në këtë rrugëtim, prandaj jam e sigurt se bashkëpunimi ynë do të intensifikohet çdo ditë e më shumë. Në luftën kundër pabarazive, kundër gjuhës së dhunës, abuzimit seksual, ngacmimit seksual, përdhunimit, paragjytimeve e padrejtësive si rezultat i mosbalancit në aspektin e pushtetit, dhe gjithnjë do të na keni në krah”, është shprehur Osmani.

Sipas saj ashtu siç është evidentuar edhe në raport, po aq sa janë të rëndësishme këto nisma dhe fushata për vetëdijësim, po aq i rëndësishëm është bashkëpunimi me njerëz që kanë pushtet brenda organizatave apo institucioneve, sepse përveç qasjes nga poshtë-lartë ne kemi nevojë për ndryshim strukturor, përmbajtësor e të qëndrueshëm.

“Ka nevojë për guxim të vazhdueshëm, insistim të vazhdueshëm, punë sistematike e këmbëngulje... Duhet ta kemi të qartë se çdo hap që na sjellë më afër realitetit të barazisë është një mundësi më shumë për ta luftuar mentalitetin dhe agresionin e ngacmimit seksual, të dhunës fizike, verbale e psiqike. Çdo hap në këtë drejtim është një hap më afër barazisë gjinore. Vajzat dhe gratë tona meritojnë vend të sigurt në punë, respekt nga të gjithë pa dallim, mirënjohje për punën dhe kontributin e tyre, vlerësim të mundid të tyre, mundësi të barabarta për avancim, garantim të sigurisë dhe ambientit të sigurisë në punë. Le të flasim sot zëshëm e të punojmë çdo ditë me bindje e përkushtim të plotë për më shumë barazi, dinjitet, respekt e fuqizim, si në art poashtu edhe në çdo fushë të jetës sonë pa dallim”, ka deklaruar Osmani.

Themeluesja dhe drejtoresha e Artpolis dhe Festivalit FemArt, Zana Hoxha, falënderoi presidenten për mbështetjen dhe prezencën e saj në një ngjarje kaq të rëndësishme.



Pas fjalëve hyrëse, bashkëautorja e Raportit Katie Watts bëri prezantimin e gjetjeve paraprake të raportit dhe rekomandimeve. Aktiviteti vazhdoi me dy panele diskutimi.

Pjesë e panelit të diskutimit “Ne duhet të flasim: Seksizmi dhe ngacmimi seksual në botën e artit” ishin Reyes Charle Cuellar, Këshilltare për Çështje Gjinore në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Katie Watts, Koordinatore e Kërkimeve dhe Publikimeve - Në lëvizje

(OTM) / Belgjikë, Miriam Engel, Koreografe, Valltare, Artiste Performuese / Izrael, Nataša Novaković, Menaxhere Produksioni – Teatri DAH / Serbi, dhe Gazmend Eju-pi, Artist, Ligjërues në UBT - (Universiteti për Biznes dhe Teknologji), Drejtor në Galerinë Paper

Kurse pjesë e panelit të dytë të diskutimit “Krijimi i hapësirave të punës dhe vendeve të punës më të sigurta të artit” ishin Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Valdete Idrizi, Drejtore e Drejtorisë së Kulturës në Komunën e Mitrovicës, Vjollca Krasniqi, Ligjëruese në Universitetin e Prishtinës & Bashkëkryetare në Qendrën për Studime dhe Hulumtime Gjinore, UP, Visar Krusha, Drejtor i Teatrit të Qytetit të Prishtinës Dodona, Florent Mehmeti, Drejtor i Teatrit ODA. Gjatë këtij aktiviteti rreth 50 persona ishin prezent në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

Siguria në punë dhe ambienti i sigurt për të menduar, vepruar e angazhuar janë të rëndësia të veçantë për të gjithë artistët/et.



## MASTER KLASË NGA MIRIAM ENGEL - ANGELA DANCE CO. / IZRAEL



Si një artiste dhe interpretuese multidisiplinare që pranon rëndësinë e teknikës së strukturuar dhe të cilësive dhe krijimtarisë individuale, Master Klasa e Miriam Engel, që u mbajt në Teatrin Kombëtar të Kosovës, ishte një përvojë e eksplorimit të shprehjes dhe zgjerimit përmes lëvizjes, duke theksuar përdorimin e plotë të potencialit fizik individual dhe virtuositetin dhe interpretimin e plotë të trupit dhe mendjes. Përdorimi i koordinimit kompleks dhe freskues, duke eksploruar kufijtë midis disa teknikave bashkëkohore; kjo përvojë energjike ofroi mjete

praktike për performancë të fortë dhe krijuese dhe interpretim të lëvizjes dhe koreografisë.

Në këtë trajnim morën pjesë 10 persona. Kjo master klasë ofroi një shije të gjuhës dhe qasjes krijuese dhe teknike të Engelit, duke përfshirë materialet e repertorit: një klasë e teknikës progresive të baletit me një qasje bashkëkohore, në orientim të balerinët bashkëkohorë. Klasa e baletit të butë dhe dinamik që eksploroj kufijtë midis linjave klasike dhe fizikës bashkëkohore, kjo klasë solli një metodë praktike të përdorimit të mjeteve nga objektivat e teknikës së baletit deri tek kërkesat individuale të balerinëve bashkëkohor dhe zhvillimit fizik.



## ECJET “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI



1Dymbëdhjetë (12) gratë pjesëmarrëse në “Qytetet Natën” takoheshin me artisten Valentina Medda, e cila i udhëzonte në rrugën që kishin zgjedhur. Secila grua kishte një orar të ndryshëm dhe një pikënisje. Këto prova ndryshonin nga njëra-tjetra, pasi rruga dhe personi që drejtonte ecjen ndryshonin. Për më tepër, duke qenë se çdo person ka përvojë personale dhe paragjykime, ndjenjat që ato përjetuan të gjithë gjatë provave të tyre ndryshonin.



## SHFAQJE TEATRORE & DISKUTIM “ENIGMA E REVOLUCIONIT” / TEATRI DAH / SERBI



Enigma e Revolucionit është një shfaqje e Teatrit DAH që kujton njëqindvjetorin e përfundimit të Luftës së Parë Botërore, revolucionet sovjetike dhe gjermane. U prezantua para publikut në Prishtinë në Teatrin Oda në prani të 100 personave. «Red Rosa», është ende një frymëzim për rebelim, në një epokë kur rebelimi kundër çdo gjëje çnjerëzore, të dhunshme dhe shfrytëzuese - është i padukshëm. Ajo ende ngre pyetjen: ku është rebelimi, a është e mundur? Hapësira e veçantë në të cilën u zhvillua shfaqja, me ndërhyrje minimale stenografike, na lejoi

të ftojme audiencën të kalonte nëpër këto «qeliza», ku ata ishin në gjendje të zgjidhnin revolucionin në të cilin ata vetë besojnë ose të mos zgjedhin asnjë. Spektatorët nuk ishin më thjesht vëzhgues «të pafajshëm» ose konsumatorë të aktit teatror - ata ishin gjithashtu bashkëpunëtorë të mundshëm që zgjodhën ose zgjidheshin të merrnin pjesë në punën e «celulave» individuale.

Ky proces zbuloi idetë, iluzionet dhe pasionet e atyre që besonin në një revolucion dhe një botë më të mirë. Kjo botë ka nevojë për një revolucion, «por çdo lot që mund të ishte shmangur është një aktakuzë» - fjalët e Rosa Luksemburgut po jehojnë në kohë.



## DITA 8 21.06.2022

### MASTER KLASË NGA MIRIAM ENGEL - ANGELA DANCE CO. / IZRAEL



Artistja izraelite Miriam Engel solli në Prishtinë përvojën e saj në koreografi. Master klasa në ditën e dytë, me 10 pjesëmarrës, përfshinte partneritetin dhe punën në dysheme, lëvizjen dhe kërkimin në hapësirë, ndërgjegjësimin dhe përmirësimin e trupit, dhe eksplorimin e gjuhës së trupit personal, në një mjedis të hapur lojërash. Një seminar i bazuar kryesisht në materialet e repertorit, duke integruar një ngrohje dhe teknikë të shkurtër dhe më pas zhytje dhe thellim në materialet, performanca dhe kontekste.



## PREZANTIM PËR MEDIA “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI



Në këtë ditë u organizua një Prezantim Mediatik (Aktivitet i Hapur) në mënyrë që publiku të merrte më shumë informacion mbi këtë aktivitet që u zhvillua gjatë Festivalit FemArt. Përveç mediave në këtë aktivitet ishin prezent rreth 30 persona.



## SHFAQJA TEATRORE “PA ZË” / SHQIPËRI



Në skenën e vogël të Teatrit Kombëtar të Kosovës u inskenua shfaqja nga Shqipëria “Pa Zë” para 60 personave. Kasandra, zgjohet e lodhur. Përmes një mesazhi në telefon merr vesh se e ëma ka vdekur. Duhet të shkruajë një fjalim për ta lexuar në funeral. Duhet të zgjedhë arkivolin për kufomën e nënës së saj. Duhet të blejë lulet që do të vendosë mbi arkivol. Duhet të zgjedhë veshjen e përshtatshme për funeralin. Duhet, por nuk mundet. Çfarë e pengon të dalë përballë njerëzve dhe të flasë për nënën e saj? Pse një shkrintare nuk mundet të shkruajë

një fjalim për personin e saj më të dashur? Çfarë ishte nëna e saj për të? Pse Kasandra zgjohet pa zë? “Pa zë” është një udhëtim tronditës dhe plot humor në psikikën femërore. “Pa zë” ndjek një grua, për një ditë, teksa ajo përpiqet të gjejë zërin e saj. Dy interpretuese shprehin konfliktin e brendshëm që ekziston brenda kokës së një gruaje moderne: shtytja dhe tërheqja, e kaluara dhe e tashmja, përparimi dhe regresioni.



## ECJET E DREJTUARA ME PUBLIKUN “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI



Secili/a anëtar/e e publikut udhëzohej nga një grua udhëheqëse e ecjeve, pjesëmarrëse e punëtorive, në rrugën që kishte zgjedhur. Secili/a anëtar/e kishte një orar të ndryshëm dhe një pikë nisjeje. Këto ecje ndryshonin nga njëra-tjetra, pasi rruga dhe personi që drejtonte ecjen ndryshonin. Për më tepër, duke qenë se çdo person ka përvojë personale dhe paragjykime, ndjenjat që ato/ata përjetuan gjatë provave të tyre ndryshonin. 32 persona morën pjesë në ecjet në qytetin e Prishtinës.



## DITA 9 22.06.2022

### DEMONSTRIM/VETËMBROJTJE “ÇIKAT E SJELLSHME” / KOSOVË



Trajnimi për vetëmbrojtje “Çikat e Sjellshme” aftëson çikat dhe gratë të pajisen me njohuri të mjaftueshme për të dalë nga situata të përkohshme me rrezik të lartë, të cilat mund të jenë potencialisht kërcënuese për sigurinë e tyre fizike (sulm, tentativë përdhunimi, grabitje, etj.).

Në korridorin e Teatrit Kombëtar të Kosovës vajzat e trajnuara nga instruktori i Taekwondo-së, Nuhi Gashi, demonstruan aftësitë e tyre të vetëmbrojtjes para 40 personave.

Përveç teknikave të vetëmbrojtjes, çikat e gratë janë përgatitur për të ndërtuar qëndrueshmëri dhe aftësi të përgjithshme fizike.

Shëndeti fizik dhe fitnesi, është një nga aspektet më të rëndësishme të mirëqenies, vetperceptimit, dhe në përgjithësi një parakusht kryesor për aspekte të tjera të jetës. Gratë dhe vajzat kosovare nuk përfshihen shumë shpesh në aktivitete fizike, gjë që çon në mungesë të aftësisë fizike, qëndrueshmërisë dhe shëndetit të përgjithshëm të dobët fizik.



## PERFORMANCË ARTISTIKE “NDAL LUFTËN” NGA MIRIAM ENGEL / IZRAEL



Artistja izraelite, Miriam Engel, dha një performancë të shkëlqyer në ditën e parafundit të Festivalit FemArt. Tek 80 personat në audiencë ajo përçoi një mesazh të rëndësishëm – Ndal Luftën.

“Ndal Luftën” është performancë bashkëkohore e vallëzimit dhe fjalës, që e ndërthur një objekt të arteve të bukura dhe instalacionin – globi i akullit. Kjo vepër ndërton një gjuhë dhe imazh nga bota e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale. Ajo mbart pyetjen se çfarë do të thotë të jesh njeri. Ajo prek dhunën në jetën tonë të përditshme

dhe vizaton një pamje të një bote të tjetërsuar dhe të vetmisë në një epokë dixhitale-moderne të teknologjisë që na ofron zëvendësues të lidhjes njerëzore.

Në botën digjitale dhe të teknologjisë që sjell zëvendësim të lidhjeve njerëzore, zgjidhje për vetminë, armë të shkatërrimit masiv dhe inteligjencë artificiale të avancuar. Ajo është “gjysmë njeri-gjysmë robot” me zemër të ngrirë dhe barkë të gjakosur. Ajo vjen në jetë me një monolog të pamëshirshëm për luftën, dhunën, humanizmin dhe dhembshurinë. “Ndal Luftën” ofroi një shprehje të humanizmit tonë. Aftësisë sonë për të përmbushur, por jo për të dominuar, për të filluar kontaktin, pëlqimin, paqen. Për të shëruar.



## ECJET E DREJTUARA ME PUBLIKUN “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI



Secili/a anëtar/e e publikut udhëzohej nga një grua udhëheqëse e ecjeve, pjesëmarrëse e punëtorive, në rrugën që kishte zgjedhur. Secili/a anëtar/e kishte një orar të ndryshëm dhe një pikë nisjeje. Këto ecje ndryshonin nga njëra-tjetra, pasi rruga dhe personi që drejtonte ecjen ndryshonin. Për më tepër, duke qenë se çdo person ka përvojë personale dhe paragjykime, ndjenjat që ato/ata përjetuan gjatë provave të tyre ndryshonin. 32 persona morën pjesë në ecjet në qytetin e Prishtinës.



## DITA 10 23.06.2022

### PREMIERA E SHFAQJES TEATRORE “ORA E VDEKJES” / KOSOVË, SHQIPËRI



Premiera e veçantë për FemArt e shfaqjes “Ora e Vdekjes”, me regji të Ilir Bokshit, ktheu publikun në kohë përmes rrëfimeve për fatin e të burgosurve politikë në Kosovë dhe Shqipëri. E inskenuar në Burgun Muze të Prishtinës kjo shfaqje i dha një goditje shpirtërore, emocionale e intelektuale 50 personave në audiencë. Por, nuk mungoi as ironizimi, që solli të qeshura tek publiku. Shfaqja përfshin edhe tregime nga të mbijetuarit (nga masakra e burgut të Dubravës) si dhe tregime nga të burgosurit nëpër burgjet e tjera. Ajo trajton jetën, moralin, identitetin,

fatet, luftën, mbijetesën dhe dashurinë, gabimin dhe pafajësinë, lirinë dhe vdekjen, të gjitha këto të gërshetuara në një koncept inovativ teatror.



## ECJET E DREJTUARA ME PUBLIKUN “QYTETET NATËN” NGA VALENTINA MEDDA / ITALI



Mbrëmja u përmbyll me ecjet e drejtuara nga gratë pjesëmarrëse të trajnimit me publikun (Event i hapur) që kontribuoi në hartimin e rrugëve të Prishtinës dhe sa të sigurta janë ato për gratë dhe vajzat të ecin të vetme gjatë natës. Në natën përmbyllëse të “Qytetet Natën” morën pjesë 32 persona.



## MBYLLJA E FESTIVALIT – PREZENTIM SPECIAL: FLAMENKO BALETI “LUXURIA”/ SPANJË



FemArt 10 u përmyll me një mbrëmje spektakolare të baletit flamenco “Luxuria” nga Spanja. Festuam jetën nën ritmin mahnitës të vallëzimit flamenco dhe tingujve relaksues të muzikës dhe këngëve spanjolle. Energjia pozitive pushtoi secilin/ën që ishte prezent në Teatrin Kombëtar të Kosovës. 350 persona në audiencë u mirëpritën në botën e pasigurisë, intrigave, dinamikave komplekse të fuqisë, dashurisë, besnikërisë dhe tragjedisë – mes një game të gjerë emocioneve dhe ndjesish të tjera të thella – në këtë kryevepër të re nga Barcelona

Flamenco Balet. Ata u mirëpritën në LUXURIA. Nën drejtimin e koreografit David Gutiérrez, “Luxuria” ka gjithçka; nga seksi tek skandali, deri tek tronditja totale dhe e paprecedentë.

Sinteza magjepsëse e stileve muzikore në këtë shfaqje baleti flamenco ishte kombinim midis muzikës klasike, xhazit dhe muzikës flamenco konvencionale duke krijuar në skenë një ambient të bukur, lirik dhe megjithatë tragjik, të mbushur me konflikte. Në përgjithësi, ky balet flamenco nuk do të harrohet për shkak të intensitetit të emocioneve, stilit unik dhe trajtimit të temave njëkohësisht thellësisht intime dhe të përhershme.



## ARTPOLIS DHE FEMART NDEROJNË ARTISTEN VJOSA BERISHA



E në fund të natës së fundit të FemArt 10 ishte koha që të nderonim artisten, gruan e guximshme, e miken tonë, Vjosa Berisha, që nuk është më në mesin tonë. Të gjithë në këmbë, dhe me një minutë heshtje nderuam angazhimin e saj artistik dhe njerëzor.



## BLLOGJET E FEMART 10

Për t'i dhënë publikut një përjetim të ri të aktiviteteve të FemArt 10 janë përkujdesur aktivistët, Ivana Bilić nga Bosnja dhe Herzegovina, dhe Alba Ajdarevikj nga Kosova. Ato kanë sjellë 11 bllogje.

### **Bllogjet mund t'i lexoni më poshtë:**

“Toka e Shpirtrave të Trazuar”, nga Ivana Bilić: <https://bit.ly/3Okvdue>

“Arti i Argëtimit dhe Kënaqësia e të Jetuarit” nga Ivana Bilić: <https://bit.ly/3tlovGG>

“Toka dhe Një Histori Njerëzore” nga Ivana Bilić: <https://bit.ly/3xJq74I>

“Gratë: Trupat, Shpirtërorja dhe Përkushtimi” nga Ivana Bilić: <https://bit.ly/3bbuJbC>

“Kosova, Toka e Shpirtrave të Trazuar - edhe Njëzet Vjet më Pas” nga Alba Ajdarevikj: <https://bit.ly/3ypgU2I>

“Burrneshat – Zgjedhje Për të Jetuar apo Konstrukt Shoqëror” nga Ivana Bilić: <https://bit.ly/3yB1dFm>

“Fuqia e Artit në Ndryshimin e Jetëve dhe Fillimin e Revolucioneve” nga Ivana Bilić: <https://bit.ly/3P9SXC1>

“Qytetet Natën - Një Ecje për të Mposhtur Frikën” nga Ivana Bilić dhe Alba Ajdarevikj: <https://bit.ly/3RrKWdv>

“Trupi im është Toka e Vetme që Zotëroj” nga Ivana Bilić: <https://bit.ly/3PnzDBr>

“Unë Nuk Jam Tepih - Nuk do t'i Lë Njerëzit të Ecin Mbi Mua” nga Ivana Bilić: <https://bit.ly/3zpOCW7>

“Emocione Goditëse në Ditën e 10-të të Festivalit Femart” nga Ivana Bilić: <https://bit.ly/3RV-F2ld>

## REZULTATET KRYESORE:

- > Organizimi i Festivalit FemArt 10 (34 aktivitete dhe 150 artiste/ë dhe aktiviste/ë)
- > Tridhjetë e katër aktivitete (34) të organizuara në kuadër të FemArt Festival 10
- > Njëqind e pesëdhjetë (150) artistë/e dhe aktivistë/e pjesë e FemArt 10
- > Dhjetë (10) vullnetarë/e të angazhuar në FemArt Festival 10
- > 2520 persona ndoqën fizikisht aktivitetet e FemArt 10
- > Kemi arritur 348,432 persona përmes rrjeteve sociale.
- > Diskutime dhe intervista mediatike
- > 52 artikuj medial
- > 11 bllogje të publikuara

# KOMUNIKIMI DHE PROMOVIMI

Të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe janë publikuar në rrjetet tona sociale. Mediat sociale të Festivalit FemArt përfshijnë sa vijon:

**Website:** [www.femart-ks.com](http://www.femart-ks.com)

**Facebook:** Femart <https://www.facebook.com/FemartKosova>

**Instagram:** femartkosovo <https://www.instagram.com/femartkosovo/>

**Twitter:** FemArtKosovo <https://twitter.com/femartkosovo/>

**YouTube:** Festivali FemArt [https://www.youtube.com/channel/UCtUEiVHQgMuQ3i\\_TaQ-oAfA](https://www.youtube.com/channel/UCtUEiVHQgMuQ3i_TaQ-oAfA)

# SFIDAT E HASURA DHE MËSIMET E MARRA

## SFIDAT:

**Agjenda e qytetit të Prishtinës në qershor ishte e stërbushur** - Duke pasur parasysh se gjatë muajit qershor janë organizuar një numër i madh ngjarjesh në fusha të ndryshme, përfshirë artin dhe kulturën, si dhe faktin se qershori njihet edhe si muaji i provimeve, mbrëmjet festive të maturantëve, si dhe muaji kur organizohen ribashkime të brezave të kaluar, ishte sfidues mbledhja e publikut fizikisht në të gjitha eventet e organizuara në kuadër të 10 ditëve të Festivalit FemArt.

**Vonesa në përgjigjet ndaj aplikacioneve tona për fonde dhe/ose vonesë në transferimin e fondeve nga donatorët** - Këtë vit, vonesa në përgjigjet ndaj aplikacioneve tona për grante për donatorët, konkretisht për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe për Komunën e Prishtinës, ka qenë problematike për sigurimin e fondeve për organizimin dinjitoz të Festivalit FemArt. Nga ana tjetër, vonesa në transfertat e fondeve që u konfirmuan nga donatorë të tjerë e thelloi këtë problem. Në vend që gjithë energjia dhe forca e stafit të Artpolis të kanalizohet në organizimin e Festivalit FemArt, duhej shpenzuar për gjetjen e zgjidhjeve të menjëhershme financiare, në mënyrë që asnjë nga aktivitetet të mos dështonte.

**Kalimi i kufijve** – Një nga sfidat gjatë Festivalit FemArt ishte ndalimi i trupës së teatrit «Burrat» nga Portugalia në kufirin Kroaci-Serbi. Ata nuk arritën të kalonin skenografinë dhe rekuizitat e shfaqjes, të gjitha të vendosura në një kamion me arsyetimin se është për qëllime komerciale, jo artistike. Pavarësisht përpjekjeve tona dhe sigurimit të dokumenteve shtesë, ata nuk arritën të kalojnë kufirin.

**Humbja e mikes sonë, artistes dhe gruas së guximshme, Vjosa Berisha** - Jemi prekur thellë nga vdekja e mikeshës, artistes dhe gruas së guximshme, Vjosa Berisha. Skena artistike, shoqëria dhe vendi ynë kanë humbur një nga gratë më të çmuara. Si një grua dhe producente autentike, Vjosa u hapi rrugën grave të tjera në industrinë e filmit dhe atë krijues.

## MËSIMET E MARRA:

**Agjenda e qytetit të Prishtinës në qershor ishte e stërbushur** - Pavarësisht sfidave, ne kemi arritur me sukses të qëndrojmë aktiv, të organizojmë Festivalin FemArt 10. Edhe pse agjenda e qytetit të Prishtinës gjatë muajit qershor ishte e stërbushur, duke punuar në mënyrë të përgjegjshme, të dashur dhe të kujdesshme, e të kesh një bashkëpunim të mirë me artistë, aktivistë, pjesëmarrës, mbështetës dhe bashkëpunëtorë ka shpërblimin e vet. Kemi mësuar se kemi një audiencë të vërtetë, mbështetëse dhe besnike ndaj Festivalit FemArt.

**Vonesa në përgjigjet ndaj kërkesave tona për fonde dhe/ose vonesë në transferimin e fondeve nga donatorët** – Edhe pse u krijua një situatë mjaft sfiduese, me punë dhe përkushtim deri në vetmi, stafi i Artpolis arriti të mbulonte shpenzimet e aktiviteteve të Artpolis. Mirëpo, kjo çështje ende nuk mund të thuhet se është mbyllur, sepse për të arritur realizimin e aktiviteteve, Artpolis ka shfrytëzuar para të dedikuara për aktivitete të tjera të ardhshme, por edhe për pagat e stafit, kështu që vazhdojmë të presim përgjigjet ndaj aplikimeve tona për grante nga institucionet më të larta dhe/ose transfertat fondesh nga donatorët për grantet e konfirmuara aktualisht.

**Kalimi i kufijve** - Edhe pse një situatë mjaft stresuese për trupën e shfaqjes dhe stafin e Artpolisit të përfshirë në organizimin e kësaj shfaqjeje, megjithatë trupa artistike e shfaqjes teatrore «Burrat» e ardhur në Kosovë e përshtati shfaqjen pa skenografinë e tyre dhe rekuizitat, duke përdorur ato të ofruara nga Teatri Kombëtar i Kosovës. Kjo u arrit edhe me shumë mund dhe përkushtim nga stafi i Artpolis dhe Teatrit Kombëtar të Kosovës.

**Humbja e shoqes, artistes dhe gruas sonë të guximshme, Vjosa Berisha** – Kur humbëm Vjosën mësuam se kujtimi i saj do të mbetet gjithmonë brenda nesh dhe do të mbahet mend për shpirtin e saj luftarak, rezistencën, dashurinë dhe pasionin për artin. Për të nderuar kujtimin e saj, ne i kushtuam asaj natën e mbylljes së FemArt Festival 10.

# MONITORIMI DHE VLERËSIMI I REZULTATEVE

Takimet Javore dhe Ditore të Artpolis/FemArt gjatë Festivalit FemArt u mbajtën për të diskutuar aktivitetet e organizuara, sfidat, mësimet e nxjerra dhe planifikimin e aktiviteteve të ardhshme.

Pas çdo aktiviteti të organizuar në kuadër të Festivalit FemArt, bëhet Monitorimi dhe Vlerësimi i situatës nga Stafi i FemArt duke organizuar takime të rregullta për të reflektuar rreth Festivalit, duke shkruar një raport me pro dhe kundër ecurisë së aktiviteteve, të cilat përdoren si pika referimi se si të merreni me këtë në aktivitetet e ardhshme të organizuara nga Artpolis/FemArt.

Dokumentet e prodhuara për të monitoruar aktivitetet:

- Listat e pjesëmarrësve në punëtori gjatë Festivalit FemArt 10.
- Dokumentimi fotografik, audio dhe video gjatë Festivalit FemArt 10.
- Monitorimi i mediave sociale – Çdo aktivitet i organizuar nga Artpolis publikohet në rrjetet/façet tona sociale.
- Mbulimi mediatik (gjeni bashkangjitur si aneks)
- Katalogu i Festivalit FemArt 10.
- Programi Festivalit FemArt 10.

# STAFI I ARTPOLIS DHE FESTIVALIT FEMART

Zana Hoxha, Themeluese dhe Drejtore Ekzekutive  
Donarta Limanaj, Menaxhere e Financave dhe Administratës  
Diellza Bezera, Menaxhere e Projekteve  
Nertila Qarri-Gërguri, Menaxhere e Projekteve  
Venera Ismaili, Zyrtare e Projekteve  
Elira Lluka, Zyrtare për marrëdhënie për publikun  
Berat Bajrami, Koordinator i Projekteve  
Arbnora Kajtazi, Asistente e Financave  
Valëza Sijarina, Asistente e Projekteve  
Alba Ajdarevikj, Praktikante  
Ivana Bilić, Praktikante



## TRUPA ARTISTIKE REZIDENTE E ARTPOLIS



Regjisore: Zana Hoxha,

Koreograf: Robert Nuha,

Dramaturg: Shpëtim Selmani

Aktorët/et: Edlir Gashi, Qendresa Kajtazi, Donikë Ahmeti, Kaltrinë Zeneli, Mikel Markaj,  
Zhaneta Xhemajli

Organizatore: Elira Lluka

## FEMART 10 U MBËSHTET NGA:

**Sponsor Gjeneral:** Buçaj SH.P.K.

**Donatorët:** EU KCR, Ambasada e Suedisë, Humanrightivism, CDF, KTK, Ambasada e Luksemburgut, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komuna e Prishtinës, cfd, UNFPA, Ambasada e Francës, Perform Europe, SDC, KCSF, K10, Ambasada e Izraelit.

**Bizneset:** Blue Taxi, Mik Mik dhe Onix Spa.

**Partnerët Institucional:** IETM, Teatri Kombëtar i Kosovës, Teatri Dodona, Biblioteka Kombëtare.

**Sponsor Medial:** Grupi KOHA.



organizuar nga

# artpolis

art and community center

SPONSOR GJENERAL:



DONATORËT:



Funded by  
the European Union



Sweden  
Sverige



KVINNA  
KVINNA

LUXEMBOURG  
AID & DEVELOPMENT



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË  
DHE SPORTIT



PRISHTINA



Die feministische  
Friedensorganisation



AMBASSADE  
DE FRANCE  
AU KOSOVO  
Albert Einstein  
Institut



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra



BIZNESET:



BLUE TAXI  
TAXI SERVICES




PARTNERËT INSTITUCIONAL:



SPONSOR MEDIAL: **KOHA**

10 VJET



FEMART

REVOLUCION / EVOLUCION  
10 VJET